



# **BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Janar 2022

# BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Janar 2022

## AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në edicionin e përmuajshëm të këtij buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin janar të vitit 2022)**

### Shpallet Konkursi për Kryeprokuror të Shtetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka marrë vendim në Takimin e 208-të për shpalljen e Konkursit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, konkurs ky, i cili shpallet së paku 90 ditë para skadimit të mandatit shtatëvjeçar të Kryeprokurorit aktual të Shtetit, i cili do të përfundojë më 21 prill 2022, si dhe themeloi edhe Panelin vlerësues për poentimin e kandidatëve që aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe përzgjedhi me short anëtarët e Komisionit për rishqyrtim të kundërshtimeve të kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit.



### Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron transparentë në procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit

KPK-ja, theksoi se, më 12 janar 2022, mori vendim për shpalljen e Konkursit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Shtetit, duke njoftuar me kohë të gjithë partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë me agjendën e takimit të 208 të saj, ku ishte caktuar si pikë e rendit të ditës propozimi për shpalljen e Konkursit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Shtetit. KPK-ja, sikurse në proceset e tjera, edhe në këtë proces do të ftojë dhe mirëpret partnerët ndërkombëtarë për monitorim, me qëllim që të jetë sa më transparente zgjedhja e Kryeprokurorit të ri të Republikës së Kosovës.

## Mbahet tryezë për vlerësimin e infrastrukturës së arkivave dhe teknologjisë informative në sistemim e drejtësisë

Kryesuesi i KPK-së mori pjesë në tryezën për prezantimin e raporteve të vlerësimit rreth infrastrukturës gjyqësore, arkivave dhe TIK-ut, e organizuar nga Programi i BE-së për Sektorin e



Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST), ku theksoi se sistemi mbetet i përkushtuar për ta përmirësuar infrastrukturën nëpër prokurori për të krijuar një ambient sa më të përshtatshëm të punës për stafin e prokurorive, ku komponenta e IT-së luan një rol kyç për arritjen e këtij qëllimi.

## Reagim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPK-ja reagoi ndaj deklaratave të pjesëmarrësve të emisionit "Tempus" me temën: "Gara për Kryeprokuror të Shtetit", i transmetuar më 25 janar 2022, në Kohavision, duke vlerësuar se deklaratimet dhe konstatimet e bëra në këtë emision kanë pasqyruar



gjendjen joreale për angazhimet e prokurorëve, anëtarëve të KPK-së dhe udhëheqësve të sistemit prokurorial në luftën kundër krimit, korrupsionit dhe të gjitha dukurive të tjera kundërligjore, gjë që u vërtetua pikërisht këto ditë edhe nga organizata ndërkombëtare, "Transparency International", që

theksoi se Kosova ka shënuar përparim në luftën kundër korrupsionit.

## KPK-ja prezantoi Planin strategjik 2022-2024 para partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile

Këshilli Prokurorial mbajti një takim për prezantimin dhe diskutimin e draftit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, ku morën pjesë edhe partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët monitorojnë sistemin prokurorial. Kryesuesi dhe Zëvendëskryesuesi i KPK-së she Kryeprokurori i Shtetit, thanë me këtë rast



se në fokus të veçantë të kësaj strategjie janë vënë ndëshkimi i korrupsionit, krimit të organizuar dhe i disa veprave të tjera penale, që, faktikisht, mbajnë peng edhe zhvillimin e vendit dhe janë shumë të rëndësishme edhe në proceset e integritetit në Bashkimin Evropian dhe se ky plan paraqet një kornizë të gjerë të veprimtarisë së sistemit prokurorial, duke u mbështetur në praktikën më të mira vendore dhe ndërkombëtare, duke falënderuar, me theks të veçantë partnerët ndërkombëtarë.

## Diskutohet avancimi i ndërlidhjes për shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet Prokurori- Polici e Kosovës

Zëvendëskryesuesi i KPK është pritur në takim nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, me ç'rast kanë diskutuar për avancimin e ndërlidhjes



për shkëmbimin elektronik të të dhënave në

marrëdhëniet mes prokurorive dhe policies dhe për zbatimin e shkëmbimit elektronik. Në takim u tha se shkëmbimi i plotë i të dhënave ndërinstitucionale ka sjellë përfitime shumë të mëdha për të dyja institucionet.

### Fillon zbatimi i Strategjisë për Sundimin e Ligjit

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës mori pjesë në takimin e parë të Komitetit Drejtues, pas miratimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit, në të cilin formalisht filloi zbatimi i Strategjisë për Sundimin e Ligjit, ku



Kryesuesi Maloku përsëriti përkushtimin dhe gatishmërinë e KPK-së për të vazhduar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe gjithëpërfshirës, me qëllim të realizimit të kësaj strategjie, duke thënë se zbatimi i saj është shumë i rëndësishëm për krijimin e një drejtësie transparente, të barabartë dhe efikase.

### Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

SKPK-ja, gjatë janarit 2022, mbajti takim me përfaqësuesit e Projektit britanik për organizimin e forumit për prezantimin e Planit strategjik 2022-2024 të sistemit prokurial.

Nga ana tjetër, bëri edhe testimin e raporteve të avancuara në SMIL dhe prezantoi idetë e ndryshme para përfaqësuesve të Projektit të USAID-it për zgjerimin e bashkëpunimit.

Po ashtu, SKPK-ja përgatiti disa drafteplane dhe drafteraportet të veçanta, siç janë ato të: Planit të Punës së KPK-së për vitin 2022, Planit të punës për Komisionin për Çështje Normative për vitin 2022 dhe Raportit për Komisionin për Çështje Normative për muajt korrik – dhjetor 2021.

Po ashtu prezantoi të gjeturat nga raportet e vlerësimit të gjendjes së tashme të infrastrukturës së prokurorive, me theks të veçantë për arkivat dhe mbajti një takim me përfaqësuesit e Projektit të USAID-it për Drejtësi në Kosovë, në të cilin është diskutuar ideja për inovacionet potenciale brenda KPK-së

Ndërkohë ka mbajtur edhe një takim në kuadër të Projektit KoSEJ II për forcimin e cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë, me ç'rast është prezantuar Raporti IV, që përfshin burimet buxhetore dhe ngarkesën në punë të lëndëve në prokurori.

### Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

NJSHPP-ja kishte në fokus një sërë punësh, ndër të cilat veçojmë: hartimin e Raportit vjetor të punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2021, hartimin e raporteve dhe informatave të nevojshme për periudhën 2015-2021 dhe Raportit përmbledhës për punën e Prokurorit të Shtetit në vitin 2021 për prezantim në Konferencën Vjetore të Prokurorëve, pastaj hartimin e Raportit për rastet e dhunës në familje për vitet 2020-2021 për Konferencën Vjetore të Prokurorëve, nxjerrjen dhe përpunimin e informatave për numrin e prokurorëve të pensionuar gjatë vitit 2021, raporte, sipas kërkesës, për statistikën e vitit 2021 për vendimet fajësuese, lëndët e bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe përqindjen e lëndëve të zgjidhura në raport me të pranuarat, si dhe hartimin e Raportit infografik për tremujorin e katërt të vitit 2021 për publikim në uebfaqe dhe hartimin e draft të Planit të punës për NJSHPP-së për vitin 2022.

Gjithashtu janë përpiluar pasqyra, raporte dhe të dhëna statistikore për gjendjen e lëndëve në prokurori për muajin dhjetor, për Trem IV-shin, Raportin vjetor 2021, punën e Prokurorisë së Apelit, Zyrën Kryeprokurorit të Shtetit, për TM IV-shin dhe për rastet që kanë të bëjnë me integritet evropian, për BE-në dhe MSA-n, si dhe raportet statistikore për trafikim me persona të mitur, për Njësitin për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike dhe për Zyrën e Koordinatorit për Krime Ekonomike dhe Sekuestrimin-Konfiskimin e Pasurisë.

Rrjedhimisht, gjatë muajit janar 2022, u zhvilluan edhe disa trajnime sa i përket fuqizimit të kapaciteteve të prokurorëve dhe unifikimit të praktikave të Prokurorisë, si dhe menaxhimit dhe hetimit të vendngjarjes dhe mbështetjes së reformës në Policinë e Kosovës.